

**UDHËZIM**  
**Nr. 3488/1, datë 23.8.2012**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 6.1.2012 “PËR  
PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT NË AUTORITETIN PORTUAL Durrës”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, nenit 84 të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, Ministri i Financave dhe Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, me propozim të Këshillit Drejtues të Autoritetit Portual Durrës, miratuar me vendimet nr. 58 dhe 59, datë 17.7.2012,

**UDHËZOJNË:**

Në udhëzimin nr. 1, datë 6.1.2012 “Për përcaktimin e tarifave të shërbimit në Autoritetin Portual Durrës”, në lidhjen që i bashkëlidhet udhëzimit bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në kapitullin 1 në pikën 1.2 “Tarifat e Portit dhe të kanalit”, nënpika 1 “Tarifat e Portit dhe të kanalit për anije për prekje”, germa “a” ndryshohet si më poshtë:

|                                                                      |      |      |
|----------------------------------------------------------------------|------|------|
| a) Për tragete deri në 13 000 GT (T1)                                | €/GT | 0.15 |
| Për tragetet mbi 13.000 GT deri 20 000 GT për çdo GT mbi 13.000 (T2) | €/GT | 0.08 |
| Për tragetet mbi 20.000 GT për çdo GT mbi 20.000                     | €/GT | 0.04 |

Pas pikës “a” shtohet pika a/1 me këtë përmbajtje:

a/1 Tarifë për çdo prekje trage, mbi 20 prekje në muaj, për çdo kompani për 1 20% zbritje (një) linjë operimi.

Përfshihen nga aplikimi i pikës a/1 më sipër periudhat e pikut, 15 korrik deri 15 shtator dhe 15 dhjetor deri 15 janar.

2. Në kapitullin 2 në pikën 3.3 “Tarifat për përpunimin e mallrave të rënda rifuxho”, artikulli 4 “Çimento rifuzo me pompë vakuumi”, shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

| <b>Tarifa e përpunimit të mallrave të rënda rifuzo</b> | <b>Njësia</b> | <b>Tarifa</b> |
|--------------------------------------------------------|---------------|---------------|
|--------------------------------------------------------|---------------|---------------|

|                                                                                                               |           |     |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|-----|
| 4/1 Çimento rifuzo me pompë vakuumi, për eksportin e volumeve të mëdha të përpunimit mbi 200 000 tonë në vit. | Lekë/tonë | 424 |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|-----|

Kjo tarifë aplikohet mbi të gjithë sasinë e eksportuar për periudhën 1.6.2012 deri 31.12.2012, nëse gjatë kësaj periudhe janë eksportuar nga i njëjti subjekt përdorues jo më pak se 80 000 tonë çimento rifuzo.

3. Në kapitullin 2 në pikën 3.7 “Tarifa e përpunimit të mallrave gjenerale”, artikulli 6 “Ngarkesa të paletizuara dhe të prepaletuara (big bags, slinga etj.)”, shtohet pika 6/1 me këtë përmbajtje:

| <b>Tarifa e përpunimit të mallrave gjenerale</b> | <b>Njësia</b> | <b>Tarifa</b> |
|--------------------------------------------------|---------------|---------------|
|--------------------------------------------------|---------------|---------------|

|                                                                                                 |           |     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|-----|
| 6/1 Çimento me slinga, për stimulimin e volumeve të mëdha të eksportit mbi 150 000 tonë në vit. | Lekë/tonë | 570 |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|-----|

Kjo tarifë aplikohet mbi të gjithë sasinë e eksportuar për periudhën 1.6.2012 deri 31.12.2012, nëse gjatë kësaj periudhe janë eksportuar nga i njëjti subjekt përdorues, jo më pak se 70 000 tonë çimento slinga.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE

**Ridvan Bode**

MINISTRI I PUNËVE

PUBLIKE DHE TRANSPORTIT  
**Sokol Ollashi**